



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:074090
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05764721

Ac.nr.8440/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Hunaida Pasuli, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit I.Q. nga Ferizaj, rr. “...” nr..., kundër debitorit N.O. nga Ferizaj, rr. “...” nr....., lidhur me çështjen përmbartimore, për borxh, duke vendosur sipas ankesës së kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.87/22, datë 18.10.2022, me datë 29.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit I.Q. nga Ferizaj, rr. “...” nr..., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.87/22, i datës 18.10.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.87/22 të datës 18.10.2022, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të Pranohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit N.O., i ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit, P.nr. 05/2021 i datës 06.01.021, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Sh.L. nga Ferizaj dhe Shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr. 05/2021 i datës 06.01.2024 si dhe Refuzohet në tërësi si i pabazuar propozimi për përmbartim i kreditorit av. I.Q., i ushtruar kundër debitorit N.O.. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të Udhëzohet kreditori që kërkesën e tij ndaj debitorit N.O. ta realizoj në procedurën kontestimore përmes padisë në gjykatën kompetente.

Kundër këtij aktvendimi kreditori brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së

drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën e kreditorit ta aprovoj në tërësi si të bazuar, ta ndryshoj aktvendimin e atakuar apo të anuloj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë si dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje ose ta leje në fuqi urdhrin përmbartimor të përmbartuesit privat.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), ka gjetur se

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës nr. 02/21 datë 04.01.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim me datë 06.01.2021, ndaj debitorit për shumën e detyrimit në lartësi prej 630 €, për të cilën shumë kreditori kërkon realizimin e borxhit, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri me kamatë ligjore nga dita e parashtrimit të propozimit e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të datës 06.01.2021, ka nxjerrë Urdhrin Përmbartimor me shenjë P.nr.05/2021 i datës 06.01.2021, me të cilën e ka lejuar përmbartimin sipas faturës nr. nr. 02/21 e datës 04.01.2020, e duke e pranuar si dokument të besueshëm, e cila i plotëson kushtet për ta lejuar përmbartimin.

Kundër Urdhrit përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 30.03.2022, duke propozuar që të aprovet prapësimi i debitorit dhe përmbartimi i lejuar nga Përmbartuesi Privat të shfuqizohet dhe të gjitha veprimet e ndërmarra të anulohen.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, me aktvendimin e atakuar PPP.nr. 87/22, të datës 18.10.2022, ka vendosur që ta aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit, duke e shfuqizuar Urdhrin Përmbartimor, P.nr.05/2021, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se me rastin e shqyrtimeve të pretendimeve të debitorit në prapësim ka konstatuar se përmbartuesi privat me rastin e caktimit të përmbartimit gabimisht ka aplikuar dispozitat e neneve të LPP-së, për arsye se fatura nr.... datës 04.01.2020 në bazë të së cilës është nxjerrë urdhri për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore nga neni 29 par. 1, nën par. 1.3 të LPP-së, për tu cilësuar si dokument i besueshëm sepse e njëjta siç shihet është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori dhe nuk është nënshkruar nga debitori. Po ashtu aktvendimet E.nr. 98/18 i datës 10.04.2018 dhe aktvendimi E.nr.98/18 i datës 25.04.2018 si dhe aktgjykimi C.nr. 719/16 i datës 13.07.2017 të gjitha të lëshuara nga Gjykata Themelore në Ferizaj nuk mund të cilësohen si dokumente përmbartimore, për shkak se siç konstatohet aktvendimi i datës 10.04.2018 është aktvendim me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori, në këtë rast i cili lëndën E.nr. 98/18 i autorizuar i debitorit dhe në këtë aktvendim siç shihet nuk ekziston ndonjë detyrim për debitorin në këtë rast kreditorit t'ia paguaj shumën e mjeteve prej 630 €, të kërkuara nga kreditori në propozimin për përmbartim. Andaj në këtë rast, vlen të theksohet se fatura në fjalë, aktvendimet dhe aktgjykimi të cilat janë cekur më lartë nuk mund të përdoren si provë vetëm në procedurën kontestimore, për çka edhe gjykata e ka udhëzuar kreditorin se i njëjti ka të drejtë të ushtroj padi për realizimin e borxhit në procedurën kontestimore, në gjykatën kompetente.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar neneve 22 paragraf 1, nën paragraf 1.1, 29 paragraf 1, nën paragraf 1.3 dhe 73 paragraf 1, 2 dhe 3 të LPP-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar dhe konstatuar gjendja faktike dhe aktvendimi i atakuar nuk përmban as shkelje të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe as Përmbartimore, sipas pretendimeve ankimore të kreditorit përmes ankesës së paraqitur.

Pretendimi ankimor i kreditorit se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbartimore pa specifikuar shkeljet e pretenduara, me arsyetimin se fatura në këtë rast është dokument i besueshëm dhe përshtatshëm për përmbartim ngase në të është treguar kreditori, debitori, objekti dhe shuma, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pabazuar, për shkak se me nenin 21 të LPP-së, përcaktohet se “ Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se më këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër ”. Në kuptim të kësaj dispozite nënkuptojmë se organi përmbartues duhet të vendos brenda kufijve të titullit përmbartues, ndërsa me rastin e vendosjes për prapësimin e debitorit, gjykata është dashur të vlerësoj se a ekziston ndonjëri nga shkaqet ligjore të parapara me nenin 71 të LPP-së, dhe se arsyetimi i gjykatës si në arsyetimin e aktvendimit të atakuar në këtë fazë të procedurës, është i drejtë dhe i bazuar në dispozitat e LPP-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se në këtë rast nuk kanë qenë të plotësuara kushte ligjore për lejimin e përmbartimit, për faktin se kjo gjykatë me shikim në shkresat e lëndës ka konstatuar dhe vërtetuar se fatura në bazë të të cilës është lejuar përmbartimi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 paragraf 3, 30 dhe 38 të LPP-së, për lejimin e përmbartimit, ngase e njëjta rezulton të mos jetë nënshkruar dhe pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori dhe se nga e njëjta faturë nuk mund të shihet se a është bërë e kërkueshme apo jo kredia e kreditorit, pasi që nuk figuron askund afati i përmbushjes vullnetare nga ana e debitorit apo më mirë thënë afati brenda të cilit debitori ka pasur për detyrim që ta bëjë pagesën e shumës së borxhit lëndor.

Me nenin 29 paragraf 1 pika 1.3 të LPP-së, përcaktohet se “ Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në to holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është ... Fatura ”. Në këtë rast në shkresat e lëndës si prova materiale gjendet fatura nr... e datës 04.01.2020.

Me nenin 29 paragraf 3 të LPP-së, përcaktohet se “ Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “. Ndërsa me nenin 30 të LPP-së, përcaktohet se “ Kur nga dokumenti i besueshëm nuk shihet se a është bërë e kërkueshme kredia, atëherë përmbartimi caktohet vetëm në qoftë se kreditori paraqet deklaratë me shkrim se kredia e tij është bërë e kërkueshme, duke u treguar edhe dita për një gjë të tillë ”. Mirëpo gjykata e shkallës së parë në rastin e vendosjes me aktvendimin e atakuar ka konstatuar se e njëjta nuk ka qenë e nënshkruar nga debitori dhe se nuk është përcaktuar afati i përmbushjes vullnetare nga ana e debitorit.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, se me rastin e pranimit të prapësimin të palës debitore të paraqitur kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbartimit, P.nr. 05/2021 i datës 06.01.2021, sepse gjykata i ka vlerësuar rrethanat e lartcekura në kuadër të

provave që i ka pasur në dispozicion në momentin e vendosjes sipas prapësimit, e nga shqyrtimi i shkresave të lëndës shihet qartë se fatura siç është prezantuar në këtë rast nuk ka cilësinë e dokumentit të besueshëm, ashtu siç është përcaktuar me nenin 29, 30, 37 dhe 38 të LPP-së.

Përveç të cekurave më lartë gjykata e shkallës së parë nuk është dashur të vlerësoj propozimin për përmbarrim dhe kërkesat që parashihen me nenin 38 paragraf 1 dhe 2 të LPP-së, e lidhur me nenin 102 të LPK-së.

Në këtë rast organi përmbarrues - Përmbarruesi privat, para se të nxjerr urdhrin përmbarrimor, ka pasur për detyrim ligjor që të vlerësoj se propozimi për përmbarrim i paraqitur nga kreditori a përmban të dhënat e mjaftueshme, të cilat kërkohen me nenin 38 paragrafi 1 të LPP-së, dhe në rast se propozimi për përmbarrim nuk ka përmbajtur të gjitha të dhënat e nevojshme, atëherë nuk ka pasur pengesa ligjore që konform nenit 17 dhe 38 paragrafi 2 të LPP-së, e lidhur me nenin 102 paragraf 1 të LPK-së, të ftoj kreditoren që brenda afatit kohor ligjor të bëjnë plotësimin, rregullimin dhe precizimin e propozimit për përmbarrim, duke e njoftuar qartë kreditorin edhe për lëshimet procedurale në rast mosveprimi sipas urdhrin të organit përmbarrues, brenda afatit kohor ligjor të dhënë, që pastaj varësisht prej veprimeve apo mosveprimeve nga ana e kreditorit, organi përmbarrues të kishte mundësi që të ndërmernte hapat tjerë procedural të paraparë me ligj, mirëpo ky detyrim në këtë rast, nuk ka qenë detyrimi i gjykatës sepse në këtë rast organ përmbarrues, ka qenë përmbarruesi privat e jo gjykata, gjykata do të kishte një detyrim të tillë sikur të ishte organ përmbarrues. Në këtë rast por edhe në raste të ngjashme kur organ përmbarrues është përmbarruesi privat, detyrimet në kuptim të dispozitave të lartë cekura bien në barrë të përmbarruesit privat.

Nga shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarrimi është caktuar në bazë të dokumentit - faturës të lëshuar nga avokati e që në rastin konkret për shkak të mangësive në të cilat konsiston, i njëjti dokument nuk paraqet bazë ligjore, për zbatimin e përmbarrimit të dhunshëm, sepse nuk e ka cilësinë e dokumentit përmbarrimor ashtu siç është përcaktuar me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm. Mirëpo nëse pala kreditore për çfarëdo rrethane i shpreson suksesit në procedurë, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e saj ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 8440/22, me datë 29.05.2024

Gjyqtare
Hunaida Pasuli